

Tirana International Fair 2026

Mundësitë e pjesëmarrjes për kompanitë

3-6 nëntor 2026 | Pallati i Kongreseve, Tiranë

TIF32 bashkon ekspozimin e produkteve dhe projekteve me takime biznesi të përgatitura paraprakisht, kontakte me investitorë dhe përfaqësim në programin publik të panairit. Për kompanitë dhe grupet shqiptare, pjesëmarrja mund të ndërtohet rreth objektivave konkrete të shitjes, furnizimit, investimit dhe komunikimit.

Priten mbi 400 biznese | 5 ekspozita | 4 ditë

Pjesëmarrje vendase dhe ndërkombëtare

Një stendë për kompaninë ose grupin

Stenda organizohet rreth produkteve, markave dhe projekteve që kompania dëshiron të prezantojë. Për grupet, një hapësirë e përbashkët mund të përfaqësojë disa kompani, me zona të dedikuara për ekspozim, demonstrime dhe takime biznesi.

Takime B2B dhe B2G të orientuara nga nevojat tuaja

Kompania përcakton paraprakisht sektorët dhe profilet e blerësve, furnitorëve ose partnerëve që kërkon. Ekipi i TIF32 identifikon pjesëmarrësit përkatës dhe koordinon takimet sipas interesit të ndërsjellë. Programi përfshin edhe mundësi takimesh me institucione përmes formatit B2G.

Program investitorësh për projekte konkrete

Në bashkëpunim me partnerë në Angli dhe SHBA, po përgatisim një program për investitorë institucionalë, përfaqësues të institucioneve financiare dhe familje investitore. Kompanitë mund të propozojnë projekte për partneritet strategjik, bashkëinvestim ose financim. Sipas profilit të projektit, mund të organizohet një takim online paraprak me partnerët e programit për të prezantuar nevojat dhe vlerësuar përputhjen e interesave.

Përfaqësim në panele dhe në skenën kryesore

Përfaqësuesit e kompanisë mund të kontribuojnë si folës në panelet sektoriale. Për produkte, projekte ose shërbime të veçanta, mund të planifikohet një prezantim i dedikuar në skenën kryesore, në hollin qendror të Pallatit të Kongreseve.

Materiale video dhe shpërndarje mediatike

Panelet realizohen me regji profesionale dhe xhirime të dedikuara. Materialet video mund të përdoren në kanalet e kompanisë dhe u vihen në dispozicion partnerëve mediatikë për publikim e shpërndarje, duke zgjatur vlerën e komunikimit edhe pas panairit.

Pesë ekspozita që lidhin sektorët

Ekspozita	Fokusi i biznesit
TIF POWER	Ndërtim dhe pasuri të paluajtshme, energji e infrastrukturë.
TIF EXPLORE	Turizëm, hoteleri dhe investime në destinacione.
TIF AGRO	Prodhim e përpunim agro-ushqimor, import, eksport, furnizim dhe certifikim.
TIF TECH	Teknologji, automatizim dhe zgjidhje digjitale për bizneset e institucionet.
GALLERY OF NATIONS	Pavijone kombëtare, kompani dhe delegacione ndërkombëtare.

Ky format lidh kërkesën mes sektorëve: zhvilluesit me hotelerinë dhe furnitorët; prodhuesit ushqimorë me blerësit e distributorët; ofruesit e teknologjisë me kompani nga disa industri. Programet e blerësve ndërkombëtarë e mbështesin këtë qasje, veçanërisht në agro-ushqim dhe turizëm.

Partnerë ndërkombëtarë që kërkojnë bashkëpunim

Gallery of Nations bashkon pavijone kombëtare, dhoma tregtie, agjenci promovimi dhe delegacione biznesi. Për kompanitë shqiptare, kjo krijon mundësi për të takuar në Tiranë kompani të huaja që kërkojnë partnerë lokalë, distributorë ose bashkëpunim në projekte.

Mes projekteve të këtij edicioni është ManiFuture Tirana 2026, në bashkëpunim me Regione Puglia dhe Unioncamere Puglia, me fokus te prodhuesit italianë nga Puglia në mobilim, arredim dhe dizajn. Projekti krijon mundësi bashkëpunimi për zhvilluesit, hotelerinë dhe distributorët në Shqipëri.

Një edicion i veçantë në Pallatin e Kongreseve

TIF32 do të shtrihet në të katër katet e Pallatit të Kongreseve, në edicionin e fundit në këtë vendndodhje përpara rikonstruksionit. Panairi organizohet nga Klik Ekspo Group që prej vitit 1994 dhe mban statusin UFI Approved Event.

Kërkoni propozimin tuaj të pjesëmarrjes

Ndani me ekipin tonë produktet ose projektet që dëshironi të prezantoni dhe profilet e kontakteve që kërkoni. Mbi këtë bazë, ju propozojmë sipërfaqen dhe pozicionimin e standës, si edhe mundësitë e përfshirjes në program dhe paketat e partneritetit.

tiranafair@klikekspogroup.com | +355 4 227 4210

Përfshirja në programin e investitorëve, panelet dhe prezantimet dakordësohet paraprakisht, sipas profilit të kompanisë, programit dhe formatit të pjesëmarrjes.